

Informacioni kryesor për investitorin

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.

Kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Fondi Investimit Albsig Standard

Është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive (SIK), e veçantë me pjesëmarrje të hapur e cila administrohet nga shoqëria administruese "Albsig Invest sh.a."

Objektivat dhe politika e investimit

Albsig Standard investon kryesisht në obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të emetuara në Lekë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat tregtare në Shqipëri. Objektivat e investimit është rritje e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Fondi për të arritur diversifikimin mund të investojë deri në 10% në tituj borxhi të transferueshëm të kompanive apo njësive vendore me seli në Republikën e Shqipërisë por këto investime nuk ndikojnë mbi tolerancën e ulët për rrezik që ka Fondi.

Investitori mund të shlyej të gjithë kuotat apo një pjesë të tyre sipas kërkesës në çdo kohë mbas investimit fillestar pa prishur normën e kthimit të realizuar deri në atë periudhë.

Fondi i Investimit Albsig Standard nuk mbështet në një tregues referencë (*benchmark*) të caktuar.

Të ardhurat nga Fondi ri-investohen dhe nuk shpërndahen. Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit. Rekomandohet që afati për investimin në Fond të jetë të paktën 2 vjet.

Performanca e fondit ndikohet kryesisht nga ecuria e normave të interesit të letrave të borxhit të Republikës së Shqipërisë. Fondi investon vetëm në klasat e aseteve të përmendura më sipër dhe nuk lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme.

Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët

Risk i lartë

Përfitime zakonisht të ulëta

Përfitime zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi i Investimit Albsig Standard ka një indikator risku në nivelin 2, pra të ulët, por nuk do të thotë që investimi është pa rrezik. Kategoria 2 përbën një risk sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator risku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator risku më të ulët. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nëpërmje një rregullore specifike përcakton lidhjen midis luhatshmërisë së fondit dhe indikatorit të riskut sintetik. Për shkak se kjo kategori sintetike përdor të dhënat historike, treguesi sintetik mund të ndryshojë në të ardhmen por ky ndryshim parashikohet të jetë i rrallë. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna relevante për profilin e ardhshëm të riskut të Fondit të Investimit Albsig Standard.

Risqet që nuk janë të përmbledhura në kategorinë e riskut sintetike janë: risku i kreditit, risku likuiditetit, risku operacional, risku i palës tjetër. Risku i kreditit mund të ndodh kur emetuesi i ndonjë obligacioni apo bono nuk është i gatshëm të paguaj interesin apo principalin në kohë. Obligacionet dhe bonot zotërojnë një spektër gradash që përfaqësojnë riskun e kredisë. Fondi do investoi kryesisht në letra borxhi të Republikës së Shqipërisë dhe është lidhur ngushtë me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar. Risku i likuiditetit lidhet me faktin se obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë nuk mund të tregtohen në çdo kohë apo do tregtohen me çmime jo të favorshme. Risku Operacional lind nga gabime të sistemeve ose gabime njerëzore të shoqërisë administruese. Risku i palës tjetër ndodh kur një pagesë të mos kryhet apo të kryhet me vonesë në një sistem transfertash për shkak të moszbatimit të kushteve të paracaktuara.

Komisionet/tarifat e Fondit

Komisionet/tarifat që investitori paguan përdoren për të shlyer kostot e administrimit të Fondit të Investimit Albsig Standard. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit. Komisionet dhe tarifatat mund të jenë subjekt ndryshimi.

Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit

Komisioni/tarifa e hyrjes - 0 %

Komisioni/tarifa i/e shlyerje - 0 %

Komisionet/tarifat të vazhdueshme që mbahen nga Fondi gjatë periudhës së një viti

Komisioni/tarifa vjetore e administrimit të Fondit – deri në 1%

Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme

- Tarifa e auditimit vjetor të fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Tarifa e depozitarit - 0.17% në vit e VNA
- Tarifa e AMF - 0.05% në vit e vlerës së përgjithshme të aseteve
- Tarifa e kostos së vazhdueshme, në një vit financiar nuk do të tejkalojnë maksimumin prej 1.5% (një pikë pesë përqind) të vlerës neto të aseteve të Fondit.

Komisionet/tarifat të tjera të mbajtura nga Fondi


Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit - sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.

Kostot e transaksioneve nuk do të përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por i mbahen Fondit.

Për më shumë informacion për komisionet, ju lutemi shihni faqet përkatëse të prospektit të Fondit, të cilin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit www.albsiginvest.al

Performanca e kaluar

Fondi i Investimit Albsig Standard për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 ka rezultuar me një normë kthimi prej 8.02%. Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së normës së kthimit. Performanca e mëparshme apo performanca afatshkurtër nuk duhet përdorur si udhëzuese e performancës në të ardhmen.



Informacione praktike

Fondi i Investimit Albsig Standard është i licencuar për të ushtuar veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë dhe mbikëqyret nga AMF.

Albsig Invest sh.a. - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive është e licencuar për të ushtuar veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë dhe mbikëqyret nga AMF.

Depozitari i Fondit të Investimit Albsig Standard është Banka e Tiranës sh.a.

Informacioni i mëtejshëm rreth Fondit të Investimit Albsig Standard mund të gjendet në Prospekt, raportet periodike dhe informacionet në faqen e internetit të shoqërisë: www.albsiginvest.al. Gjithashtu në faqen e internetit të shoqërisë: www.albsiginvest.al publikohen çdo ditë të dhënat ditore mbi ecurinë

e Fondit, si çmimi i kuotës dhe vlera neto e aseteve të Fondit.

Legjislacioni tatimor mund të ketë një ndikim në tatimin personal të investitorit – shtetas i huaj.

Shoqëria administruese konsiderohet përgjegjëse e vetme për çdo keqkuptim, pasaktësi ose parregullsi që gjendet në këtë dokument, në ndryshim nga pjesët përkatëse të prospektit të Fondit.

Albsig Invest sh.a është licencuar në Shqipëri sipas vendimit nr. 210, datë 22/11/2019 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtarinë si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit si dhe administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Fondi i Investimit Albsig Standard - Sipërmarrje Investimesh Kolektive (SIK) është miratuar në Shqipëri më datë 30/12/2019, me licensimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendim nr. 255. Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar.

Këto informacione kryesore për investitorin janë të sakta më datën e publikimit 22.02.2024.